



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2569/6 prot

Datë 01.12.2022

V E N D I M
Nr.1183 /2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.12.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-48622-11-04-2022, me objekt “Blerje uniforma dhe këpucë për Policinë e Burgjeve” e ndarë në dy lote” me fond limit 772,121,465.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 07.12.2022, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Ankimues: “Marsi & AL” SHPK
Rruga “Sami Frashëri”, Pallati i Aviacionit, kati II, Ap.4

Autoriteti Kontraktor: Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nd. 1, 1001, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.

500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi ankesën e ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi nuk ka plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 07.11.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-48622-11-04-2022, me objekt “Blerje uniforma dhe këpucë për Policinë e Burgjeve” e ndarë në dy lote” me fond limit 772,121,465.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 07.12.2022, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 18.11.2022, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur ankesa me nr. 2569 prot., e operatorit ekonomik “Marsi & AL” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëngjitur ankesës së mësipërme konstatohet, se formulari i ankesës së dorëzuar është me të meta, pasi mungon dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesat e plota të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës me nr. 2569/2 prot., datë 24.11.2022, me objekt “Kërkesë për informacion” KPP iu drejtua autoritetit kontraktor Agjencia e Prokurimeve të Përqendruara me kërkesën si vijon: *“Në datën 18.11.2022, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me ankimi nr. 2569 prot., datë 18.11.2022 e operatorit ekonomik “Marsi & AL” SHPK, për procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-48622-11-04-2022, me objekt “Blerje uniforma dhe këpucë për Policinë e Burgjeve” e ndarë në dy lote” me fond limit 772,121,465.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 07.12.2022, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëngjitur ankesës së mësipërme konstatohet se formulari i ankesës është me të meta, pasi mungon dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur.

Për sa më sipër, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik kërkon të informohet në lidhje me veprimet procedurale të kryera nga institucioni juaj sipas parashikimeve të nenit 111/3 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 94/4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.”

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 1775/4 prot., datë 30.11.2022, protokolluar me tonën me nr. 2569/2 prot. datë 01.12.2022 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor lidhur trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Marsi-AL” SHPK, ku rezulton se me vendimin e KSHA nr. 1775/2 prot., datë 25.11.2022 është refuzuar ankesa e operatorit ekonomik ankimues ku ndër të tjera argumenton se: *“[...] Komisioni i shqyrtimit të Ankesave shqyrtoi formularin e ankesës së paraqitur nga OE “Marsi & AL” SHPK si dhe dokumentacion bashkëlidhur tij dhe konstatoi se mungon mandati i pagesës për tarifën përkatëse të kësaj ankesë. Gjithashtu KSHA shqyrtoi të dhënat e publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik lidhur me këtë ankesë dhe konstatoi se statusi i saj është “Pa paraqitur”.*

Bazuar në pikën 4 të nenit 94, të VKM 285/2022 ku përcaktohet: “4. Në rast se autoriteti/enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është bërë sipas formularit standard ose i mungon ndonjë prej elementeve të sipërpërmendura ose nuk është shoqëruar me mandat pagesën, duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë dhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me veprimet e mësipërme, për korrigjimin e të metave të ankesës.” Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës në datë 18.11.2022 ka njoftuar nëpërmjet postës elektronike operatorin ekonomik ankimues lidhur me mungesën e mandatit të pagesës dhe plotësimin e ankesës me të gjitha elementët e saj në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik. Gjithashtu KSHA ka dërguar në adresën e e-mail të OE “Marsi &AL” SHPK një e-mail të dytë në datën 21.11.2022 me qëllim rikujtimin e pagesës së tarifës përkatëse. (bashkëlidhur gjeni komunikimin elektronik.)”

II.6. Me qëllim verifikimin e mëtejshëm në lidhje me pagesën e tarifës financiare , KPP ju drejtua me memon nr. 2596/4 datë 01.12.2022 Drejtorisë së Monitorimit, Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës pranë KPP për informacion mbi pagesën e tarifës financiare të kryer nga operatori ekonomik “Marsi & AL” SHPK për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.7. Me memon nr. 2596/5 prot., datë 01.12.2022 Drejtoria e Monitorimit, Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës informon se: “Në përgjigje të memos nr. 2569/4 prot., datë 01.12.2021 për verifikimin e pagesës së operatorit ekonomik “Marsi & AL” SHPK për ankesën nr. 2569 prot., ju informoj se pas kontrollit të dokumentacionit fizik në dispozicion në Drejtorinë e Monitorimit , Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës dhe kontrollit në seksionin Mandat Pagesë në Sistemin e Menaxhimit të Ankesave Elektronik rezulton se nuk është paraqitur dokument bankar që vërteton kryerjen e pagesës.”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit të dosjes si edhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me ankesën e paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik në datë 18.11.2022, me nr. 2569 prot., nga operatori ekonomik “Marsi & AL” SHPK për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk ka kryer pagesën e tarifës financiare për ankesën e mësipërme, në përputhje me përcaktimet në nenin 111, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se:

“1. Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik.

Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paraqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”

III.1.1. Në gërmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, është parashikuar se:

“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji”.

III.1.2. Nëpërmjet shkresës me nr. 2569/2 prot., datë 24.11.2022, me objekt “Kërkesë për informacion” KPP iu drejtua autoritetit kontraktor Agjencia e Prokurimeve të Përqendruara me kërkesën si vijon: *“Në datën 18.11.2022, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me ankimi nr. 2569 prot., datë 18.11.2022 e operatorit ekonomik “Marsi & AL” SHPK, për procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-48622-11-04-2022, me objekt “Blerje uniforma dhe këpucë për Policinë e Burgjeve” e ndarë në dy lote” me fond limit 772,121,465.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 07.12.2022, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëngjitur ankesës së mësipërme konstatohet se formulari i ankesës është me të meta, pasi mungon dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur.

Për sa më sipër, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik kërkon të informohet në lidhje me veprimet procedurale të kryera nga institucioni juaj sipas parashikimeve të nenit 111/3 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 94/4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.”

III.1.3. Nëpërmjet shkresës nr. 1775/4 prot., datë 30.11.2022, protokolluar me tonën me nr. 2569/2 prot. dhe 2190/2 prot., datë 17.10.2022, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor lidhur trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Marsi & AL” SHPK, ku rezulton se me vendimin e KSHA nr. 1775/2 prot., datë 25.11.2022 është refuzuar ankesa e operatorit ekonomik ankimues ku ndër të tjera argumenton se: “[...] Komisioni i shqyrtimit të Ankesave shqyrtoi formularin e ankesës së paraqitur nga OE “Marsi & AL” SHPK si dhe dokumentacion bashkëlidhur tij dhe konstatoi se mungon mandati i pagesës për tarifën përkatëse të kësaj ankesë. Gjithashtu KSHA shqyrtoi të dhënat e publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik lidhur me këtë ankesë dhe konstatoi se statusi i saj është “Pa paraqitur”.

Bazuar në pikën 4 të nenit 94, të VKM 285/2022 ku përcaktohet: “4. Në rast se autoriteti/enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është bërë sipas formularit standard ose i mungon ndonjë prej elementeve të sipërpërmendura ose nuk është shoqëruar me mandat pagesën, duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë dhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me veprimet e mësipërme, për korrigjimin e të metave të ankesës.” Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës në datë 18.11.2022 ka njoftuar nëpërmjet postës elektronike operatorin ekonomik ankimues lidhur me mungesën e mandatit të pagesës dhe plotësimin e ankesës me të gjitha elementët e saj në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik. Gjithashtu KSHA ka dërguar në adresën e e-mail të OE “Marsi &AL” SHPK një e-mail të dytë në datën 21.11.2022 me qëllim rikujtimin e pagesës së tarifës përkatëse. (bashkëlidhur gjeni komunikimin elektronik.)”

III.1.4. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor. Një prej elementeve të domosdoshme për paraqitjen e ankesës është edhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimuesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t’i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cenon parimin e efijencës në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimuesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimuesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të depozituar në KPP përmes shkresës nr.1775/4 prot., datë 30.11.2022 protokolluar me tonën nr. 2569/3 prot., datë 01.12.2022 rezulton, se autoriteti kontraktor ka zbatuar përcaktimet e bëra nga ana e ligjvënësit në pikën 3 të nenit 111 të LPP-së, duke respektuar hapat proceduralë që parashikon kjo dispozitë ligjore, sepse përmes komunikimit elektronik i ka kërkuar operatorit ekonomik ankimues “Marsi & AL” SHPK, ndreqjen e të metave të ankesës, si në rastin konkret kryerjen e pagesës së tarifës për ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor Agjencia e Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimimi si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Komisioni Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi faktet dhe provat bashkëlidhur dokumentacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor thekson, se ky i fundit ka njoftuar dy herë (me datë 18.11.2022 dhe 21.11.2022) operatorin ekonomik ankimues përmes komunikimit elektronik në lidhje me korrigjimin e mangësive të konstatuara në lidhje me elementet formale të ankesës, konkretisht pagesës së tarifës së ankesës.

III.1.5. Në këto kushte Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimues nuk është privuar nga mundësia që i jep ligji për të korrigjuar një prej elementeve formale të domosdoshme. Fakti që nuk ka korrigjuar të metat e ankesës, si në rastin konkret pagimin e tarifës së ankesës, nuk e ka privuar këtë të fundit nga një prej të drejtave më themelore në procedurat e prokurimit publik, që është e drejta e ankimit.

Referuar arsyetimit, në kushtet kur operatori ekonomik ankimues nuk ka paguar tarifën financiare të ankesës si dhe ka refuzuar ndreqjen e të metave sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Komisioni gjykon, se ankesa operatorit ekonomik “Marsi & AL” SHPK nuk plotëson një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës, ndaj, bazuar në gërmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, kjo ankesë duhet refuzuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e

Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Marsi & AL” SHPK, për procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-48622-11-04-2022, me objekt “Blerje uniforma dhe këpucë për Policinë e Burgjeve” e ndarë në dy lote” me fond limit 772,121,465.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 07.12.2022, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar
Fiorent Zguro	Kreshnik Ternova	Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri